



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

UDHËZIM

Nr. 660, Datë 28.09.2018

**PËR
KRIJIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË TRAJNIMIT DHE
CERTIFIKIMIT BAZUAR NË TESTIM, NË SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË TË
PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTUR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës ç, të nenit 28 të ligjit 9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikës 10, kreu I i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”,

UDHËZOJ:

1. Krijimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Trajnimit dhe Certifikimit Bazuar në Testim, në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur, sipas shtojcës 1 dhe 2 bashkëngjitur këtij Udhëzimi.
2. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, të gjitha Bashkitë si dhe të gjitha Shoqëritë Aksionere Ujësjellës Kanalizimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

Damian GJIKNURI



SHTOJCA 1

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i Udhëzimit është krijimi i një mekanizmi institucional të qendrueshëm për trajnimin dhe certifikimin bazuar në testim të kapaciteteve njerëzore në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur.

Neni 2

Objekti

1. Objekti i Udhëzimit është trajnimi i vazhdueshëm i stafeve teknike dhe menaxheriale të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, si dhe të stafeve të çdo operatori të licensuar nga Enti Rregullator i sektorit për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur.
2. Objekt i Udhëzimit është hartimi, rregullimi dhe zbatimi i Programit të Certifikimit Bazuar në Testim, sipas manualit teknik, në shtojcën 2 të këtij Udhëzimi.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky Udhëzim zbatohet ndaj të gjithë punonjësve të shoqërive ujësjellës kanalizimeve, sipas kategorive të përshkruara në manualin teknik, në shtojcën 2.
2. Ky Udhëzim zbatohet ndaj të gjithë punonjësve të çdo operatori të licensuar nga Enti Rregullator i sektorit, për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur.

Neni 4

Fusha e certifikimit bazuar në testim

1. Fushat e certifikimit bazuar në testim, për drejtuesit dhe punonjësit teknik, sipas pikës 2, të nenit 5 të këtij udhëzimi janë:

- a. Shpërndarja e ujit, që përfshin procesin e përçimit të ujit të trajtuar e të pijshëm nga rezervuaret nëpërmjet tubacioneve të transmetimit në rrjetin e shpërndarjes për tek konsumatori.
 - b. Prodhimi dhe trajtimi i ujit, që përfshin elementët operacional të grumbullimit të ujit nga burimet, duke e trajtuar atë për të zvogëluar ose larguar ndotësit ekzistues ose bakteriet në një nivel të tillë që uji të plotësojë standardet për konsum njerëzor.
 - c. Grumbullimi i ujërave të ndotura, që përfshin procesin e grumbullimit të ujërave të ndotura nga lidhjet e konsumatorëve individual dhe transportimi i tyre me anë të një sistemi tubash, pusetash, stacione pompimi dhe struktura të tjera në pikën përfundimtare për trajtimin.
 - d. Trajtimi i ujërave të ndotur, që përfshin procesin e shndërrimit të ujërave të ndotura në një fluid të trajtuar që mund të rikthehet në një trup ujor pritës si përroi, lumi, liqeni apo deti, për të përmbyllur kështu ciklin natyror të ujit, me ndikimin minimal në mjedis, ose mund të ripërdoret/ bonifikohet. Ripërdorimi nënkupton përdorimin e ujit të trajtuar për qëllime të ndryshme, për aq sa përmbushen standarde të cilësisë së tij.
2. Fushat e certifikimit bazuar në testim për administratorin/drejtuesin e shoqërisë aksionere të ujësjellës kanalizimeve dhe drejtuesin tregtar të shoqërisë dhe punonjësit e drejtorisë/departamentit tregtar, do të përcaktohen me udhëzimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën, brenda 12 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi.

Neni 5

Nivelet e Certifikimit Bazuar në Testim

1. Certifikimi Bazuar në Testim organizohet në certifikim për drejtuesit dhe punonjësit teknik (menaxherial dhe operacional), si dhe certifikim bazuar në testim për administratorin/drejtuesin e shoqërisë aksionere të ujësjellës kanalizimeve dhe drejtuesin tregtar të shoqërisë dhe punonjësit e drejtorisë/departamentit tregtar.
2. Certifikimi Bazuar në Testim për drejtuesin/drejtuesit dhe punonjësit teknik (menaxherial dhe operacional) të shoqërisë aksionere ujësjellës kanalizimeve organizohet në katër nivele:
 - a. Niveli 4 – Drejtor Teknik

- b. Niveli 3 – Menaxher
 - c. Niveli 2 – Mbikqyrës
 - d. Niveli 1 – Punonjës i kualifikuar
3. Certifikimi Bazuar në Testim për Administratorin/Drejtesin e shoqërisë aksionere të ujësjellës kanalizimeve do të organizohet në:
- a. Kategoria 1- Administrator/ Drejtor i Përgjithshëm
4. Certifikimi Bazuar në Testim për Drejtuesin Tregtar të shoqërisë dhe punonjësit e drejtorisë/departamentit tregtar do të organizohet në katër nivele:
- a. Niveli 4 – Drejtor tregtar (apo pozicion i njëjtë)
 - b. Niveli 3 – Menaxher
 - c. Niveli 2 – Mbikqyrës
 - d. Niveli 1 – Specialist
5. Përshkrimet për secilin nivel të parashikuar në pikën 2 të këtij Udhëzimi, kriteret e kualifikimit dhe kërkesat minimale për t’ju nënshtuar procesit të testimit rregullohen në shtojcë 2 “**Manuali Teknik për Programin Kombëtar të Trajnimit dhe Certifikimit bazuar në Testim.**”.
6. Përshkrimet për secilin nivel të parashikuar në pikën 3 dhe 4 të këtij Udhëzimi, kriteret e kualifikimit dhe kërkesat minimale për t’ju nënshtuar procesit të testimit do të hartohen nga Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën dhe do të miratohen me udhëzimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën, brenda 12 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi.

Neni 6

Afati i certifikimit dhe rinovimi

1. Certifikata për secilën kategori të parashikuar në nenin 5, është e vlefshme për një periudhë 3 vjeçare.
2. Për të ruajtur të njëjtin nivel certifikimi, punonjësi grumbullon numrin minimal të orëve të trajnimit ose të pjesëmarrjes në konferenca/ seminare vjetore që trajtojnë temat e fushës përkatëse të cilat mund të zëvendësojnë orët e trajnimit sipas një raporti konvertimi të përcaktuar nga Bordi i Certifikimit. Në rast se orët e përcaktuara sipas kësaj pike përmbushen, certifikata rinovohet automatikisht.

3. Në rast se punonjësi nuk plotëson kushtet e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, si dhe në rastet kur punonjësi kërkon të certifikohet për një kategori më të lartë, ai i nënshtrohet testimit.

Neni 7

Institucionet përgjegjëse

1. Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën harton standardet për certifikimin, miraton kurrikulat e trajnimit dhe testimet e certifikimit.
2. Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën krijon dhe kryeson Bordin e Certifikimit.
3. Agjensia Kombëtare Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve:
 - a. Administron procesin e aplikimit për certifikim;
 - b. Përpunon, rishikon dhe miraton aplikimet për kryerjen e testimit;
 - c. Dorëzon listën e kandidatëve të miratuar pranë ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën;
 - d. Administron procesin e testimit;
 - e. Vendos në dijeni Bordin e Certifikimit për rezultatet e testimit;
 - f. Luan rolin e Sekretariatit për Bordin e Certifikimit;
 - g. Ruan të dhënat e aplikimeve dhe rezultatet e testimit;
 - h. Ofron informacion për kandidat për certifikim mbi programet e trajnimit, që kanë lidhje me certifikimin e tyre;
 - i. Përpunon aplikimet për ricertifikim;
 - j. Siguron mbarëvajtjen e gjithë Programit të Certifikimit Bazuar në Testim duke përfshirë dhe përditësimin e pyetjeve të testimit për të garantuar përputhshmërinë e tyre me kontekstin ligjor-administrativ, teknologjik, etj
4. Enti Rregullator i Ujit gjatë procesit të licensimit të operatorëve që ofrojnë një ose disa nga shërbimet në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur, siguron që stafi drejtues i shoqërisë gëzon certifikatën përkatëse, në përputhje me pozicionin e punës.
5. Shoqata Ujësjetës Kanalizime e Shqipërisë asiston MIE, AKUM, ERRU në hartimin e kurrikulave, ofron trajnime, si dhe përcjell pranë institucioneve përgjegjëse mendimet dhe sugjerimet e anëtarëve të saj.

6. Bordi i Çertifikimit mbikëqyr programin e certifikimit si dhe lëshon certifikatat në përfundim të procesit të testimit.

Neni 8

Bordi i certifikimit

1. Bordi i Certifikimit kryesohet nga Zëvendësministri përgjegjës për sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur dhe përbëhet nga:
 - a. 2 anëtarë nga Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën
 - b. 1 anëtar nga AKUM
 - c. 1 anëtar nga ERRU
 - d. 1 anëtar nga SHUKALB
 - e. 2 anëtarë nga Shoqata e Bashkive
 - f. 1 anëtar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës
 - g. 1 anëtar nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

Neni 9

Administrimi i procesit të testimit dhe certifikimit

1. Agjensia Kombëtare Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve miraton brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi, rregulloren për administrimin e procesit të testimit dhe certifikimit.